



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-1633/13</u>
Nr. I faq. Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>31-05-2013</u>
Nr. pages	Date
PRISHTINË	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 21.05.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllët rasti më nr.AKK-03-450\13, për zyrtarin e lartë z.Miran Zeneli, Drejtor Ekzekutiv, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publikë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.1 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Pas identifikimit të rastit, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokolli AKK-03-451/13, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Miran Zeneli, Drejtor Ekzekutiv, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, ku është dyshuar për gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit, pasi që ushtron edhe pozitën e personit të autorizuar dhe pronarit në biznes privatë.

Agjencia kundër Korrupsionit me datën 19.03.2013, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, zyrtari i lartë z. Miran Zeneli, pasi ka kontaktuar me zyrtarët e Agjencisë ka kërkuar të takohemi dhe të bisedojmë rreth çështjes së ngritur, sipas procedurës, është organizuar takimi me z. Zeneli, ku dhe i kemi shpjeguar për fillimin e hetimeve lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Gjatë takimit zyrtari në

fjalë e ka potencuar se ushtron funksionin e Drejtorit Ekzekutiv, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, dhe ka në bashkëpronësi dhe është dhe person i autorizuar bizneset me emër "ALKO Pharam- sh.p.k" dhe "SO.GE.S.I.A-sh.p.k".

Gjatë takimit zyrtari në fjalë ka pranuar dëshmitë e AKK-së dhe është zotuar se në afat sa me të shpejtë do të bëjë ndryshimet e kërkuara dhe do ta shmange çfarë do situatë që mundë të shkaktoj konflikt të interesit.

Pas këtij takimi zyrtari I lartë me datën 10.05.2013, ka sjellë në Agjenci dëshmitë e lëshuara nga ARBK-ja, ku dëshmon se ka bërë ndryshimet dhe nuk është me person i autorizuar ne bizneset e sipërpërmendura .

Duke u bazuar ne dëshmitë e ofruara nga zyrtari i lartë z. Miran Zeneli, Drejtor Ekzekutiv, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës si dhe ne gjendjen faktike që gjendet zyrtari,

Konstatojmë se : zyrtari i lartë z. Miran Zeneli, Drejtor Ekzekutiv, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në te cilën ndodhej pasi që ka ber ndryshimet e kërkuara dhe nuk gjendet ne situatë të papajtueshme me Funksionin e tij Publik si Drejtor Ekzekutiv në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

